



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës Liridon Kastrati, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kamenicës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erbllin Hetemi, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 11/06 /2024 Nr. 020-388
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit të Monitorimit 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Driton Xhafa, Zyrtar për Monitorimin e Komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë e aktit të komunës së Kamenicës	
Lloji i aktit:	Vendimit	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim nr. 18601 për shpalljen në interes të përgjithshëm publik
I miratuar në komunë me datë : 30.05.2024
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.06.2024

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024, ka miratuar vendimin nr. 18601 për shpalljen në interes të përgjithshëm publik.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës është i bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale neni 12, Ligjin Nr.06/L-92 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës nenin 27 paragrafi 1 dhe 2.

Vendimi nr. 18601 për shpalljen në interes të përgjithshëm publik është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Kamenicës me datë 30.05.2024, me 12 vota për, 1 kundër dhe 0 abstenim. Qellimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik për pronën e cila është në menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit bëhet për realizimin e projektit për ndërtimin e Strehimores për Qenët Endacak”.

Komuna pas marrjes së vendimit për shpallje të interesit të përgjithshëm publik për pronat e menaxhuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit duhet të zhvillojnë procedurat për bartjen e këtyre pronave. Të drejtën e bartjes të pronave të menaxhuara nga AKP-ja, komunat mund ta realizojnë përmes procesit të shpronësimit dhe Ligjit Nr.06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-034 për agjencinë kosovare të privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-115 dhe me Ligjin Nr.05/L-080.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Kadri Rahimaj, gradonačelnik opštine Kamenica Liridon Kastrati, predsedavajući Skupštine opštine Kamenica	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Jeton Qela, v.d. generalnog sekretara MALS-a,	
Od:	Erbilin Hetemi, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Dana, 11.06.2024. Br. 020-388
Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština	
Službenik-ca za izradu pravne procene:	Driton Xhafa, službenik za monitorisanje opština	
Predmet:	Zahtev za razmatranje akta Skupštine opštine	
Vrsta akta:	Odluka	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosovo br. 10/2019 o administrativnom razmatranju akata opština, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju akata opština, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva utvrđenih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi sledeći opštinski akt:

Odluka br. 18601 o proglašenju od opšteg javnog interesa
Usvojena dana, 30.05.2023.
Podnošena na razmatranje u MALS-u dana, 06.06.2023.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, ocenjuje da je akt opštine u proceduralnom aspektu u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Skupština opštine Kamenica, na sednici održanoj dana, 30.05.2024, usvojila je Odluka br. 18601 o proglašenju od opšteg javnog interesa.

MALS, konstatuje da je odluka doneta od strane Skupštine opštine Kamenica, zasnovana na Zakonu br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, članu 12. I Zakonu br.06/L-92 o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine, članu 27. stav 1 i 2.

Odluka br. 18601 o proglašenju od opšteg javnog interesa, usvojena je na sednici Skupštine opštine Kamenica dana, 30.05.2024. godine, sa 12 glasa "za", 1 "protiv" i 0 "uzdržanih". Svrha proglašenja opšteg javnog interesa za imovinu kojom upravlja Kosovska agencija za privatizaciju je realizacija projekta izgradnje Skloništa za pse lutalice".

Nakon donošenja odluke o proglašenju opšteg javnog interesa za imovinu kojom upravlja Kosovska agencija za privatizaciju, opština mora da razvije procedure za prenos ove imovine. Opštine mogu ostvariti pravo na prenos imovine kojom upravlja KAP kroz proces eksproprijacije i Zakona br. 06/L-023 o izmenama i dopunama Zakona br. 04/L-034 o Kosovskoj agenciji za privatizaciju, izmenio sam i dopunjen Zakonom br. 04/L-115 i Zakonom br. 05/L-080.

Ministarsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.